



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 29
Prishtinë, më 15 qershor 2016, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-I-

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCAVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Faton Topalli, Synavere Rysha, Ali Sadriu, Naim Fetahu, Fikrim Damka, Hajdar Beqa dhe Abdyl Ymeri.

Munguan: Bali Muharremaj dhe Enver Hoti.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatore e Komisionit; Mehmet Simnica, zyrtar i fushës dhe Mentor Hyseni, ekspert nga GIZ- i.

Pjesëmarrësit e tjerë në takim: Vlora Mehmeti, Valbon Bytyçi, Arben Selimi, Arian Haxha nga ZKA, Blerta Bejtullahu- BE dhe Furkan Ergiler-Kuvend.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.5.2016;
3. Shqyrtimi i raporteve kthyese të organizatave buxhetore, për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike;
4. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.5.2016

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 11.5.2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raporteve kthyesë të organizatave buxhetore, për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike

Faton Topalli, kryetar, theksoi se është njoftuar nga stafi dhe nga procesverbali, që keni qenë në proces të mbikëqyrjes së rekomandimeve të cilat i ka dhënë Komisioni gjatë vitit 2015 për disa organizata buxhetore, sa janë implementuar këto rekomandime nga ana e tyre.

Po ashtu ai tha se jam njoftuar që ky proces ka qenë i ndarë në grupe, ku një deputet ka mbikëqyrë implementimin e rekomandimeve për dy- tri institucione, së bashku me auditorët e jashtëm dhe stafin. Nga stafi jam njoftuar që ndarja ka qenë kështu: Deputetja Synavere Rysha ka mbikëqyrë implementimin e rekomandimeve që janë dhënë për Ministrin e Financave, Doganën e Kosovës dhe Njësinë Qendrore harmonizuese. Deputeti Fikrim Domka ka mbikëqyrë implementimin e rekomandimeve që janë dhënë për Ministrinë e Shëndetësisë. Deputeti Naim Fetahu ka mbikëqyrë implementimin e rekomandimeve që janë dhënë për Ministrin Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, për Ministrin e Integritetit dhe Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Deputeti Abdyl Ymeri ka mbikëqyrë implementimin e rekomandimeve që janë dhënë për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Policinë e Kosovës. Deputeti Hajdar Beqa ka mbikëqyrë implementimin e rekomandimeve që janë dhënë për Ministrinë e Administratës Publike. Do të ishte mirë që secili nga ju ta prezantojë gjendjen e këtyre institucioneve, sa nga to i kanë implementuar rekomandimet e Komisionit. Po fillojmë me Deputeten Synavere Rysha. Me këtë e hapi diskutimin.

Synavere Rysha: Unë kam mbikëqyrë rekomandimet për MF, Doganën e Kosovës dhe NJQH, marr në përgjithësi implementimi i rekomandimeve ishte në nivel të kënaqshëm. Për të analizuar këtë, ne kemi organizuar takime të ndara me përfaqësuesit e institucioneve, si dhe me auditorët që kanë hartuar këto raporte. Përqindja e implementimit të rekomandimeve është mbi 66.66% të MF nga 8 rekomandime, 2 nga to nuk janë realizuar ende, ndërsa të Dogana përqindja e implementimit të rekomandimeve është 84.6%. Vlen të theksohet se nivel të kënaqshëm ka arritur NJQH ku mbi 95% e tyre janë implementuar. Ajo që tani paraqet problem është Ligji për Auditimin e Brendshëm i cili është në ndryshim- plotësim në Qeveri e që Auditorët e brendshme i barazojnë me paga, si dhe me përgjegjësi në nivel të zyrtarëve të tjerë. Kjo mendojë do të jetë e papranueshme.

Fikrim Damka: Unë kam mbikëqyrë zbatimin e rekomandimeve për MSH, këtë e kemi realizuar përmes takimeve që kemi pasur me MSH, si dhe me auditorët e ZKA që kanë hartuar raporte për MSH. Problem në vete paraqet sistemi informativ shëndetësor, ku pa një sistem informativ shëndetësor të mirëfilltë nuk mund të ketë edhe sigurime shëndetësore. MSH ka përfituar një donacion në shumën prej 17 milionë euro, i cili deri tani është shpenzuar deri në shumën prej 4 milionë euro. Megjithatë Ministrisë së Shëndetësisë ju kemi dhënë afat kohor

shtesë që deri në fund të muajit qershor të e dorëzojë planin e veprimit se deri ku kanë arritur me implementimin e rekomandimeve.

Naim Fetahu: Unë kam pasur disa organizata buxhetore për mbikëqyrje të zbatimit të rekomandimeve, si për MMPH, MIE, MAP dhe MPMS.

Për MMPH Komisioni ka dhënë 13 rekomandime për të cilat është kërkuar që në afat prej 3 muajve të hartojë planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve dhe për këtë ta njoftojë Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike. Në bazë të diskutimeve të përbashkëta edhe me Auditorët e jashtëm, mund të konkludojmë që për këtë vit vërehen përmirësime në MMPH, ka adresuar mbi 90% të rekomandimeve, por që ende mbetet punë për të bërë, sepse janë një numër i madh i rekomandimeve që janë në proces të implementimit, por që duhet të implementohen plotësisht.

Po ashtu MIE nuk i është përgjigjur Komisionit në këtë takim. Megjithatë, në bazë të diskutimeve të përbashkëta edhe me Auditorët e jashtëm, mund të konkludojmë që për këtë vit vërehen përmirësime në MIE, ka adresuar mbi 90% të rekomandimeve, por që ende mbetet punë për të bërë, sepse janë një numër i rekomandimeve që janë në proces të implementimit, por që duhet të implementohen plotësisht.

Ministria e Administratës Publike, nga gjithsejtë 11 rekomandime, ka arritur t'i adresojë 3 prej tyre plotësisht, ndërsa 7 prej tyre janë adresuar pjesërisht, ndërsa një nuk është adresuar fare. Ministria e Administratës Publike, të ketë një qasje me konkrete me rastin e adresimin të rekomandimeve, të dhëna nga KMFP.

Sa i përket MPMS situata është më mirë, ngase në bazë të diskutimeve të përbashkëta edhe me Auditorët e jashtëm, mund të konkludojmë që për këtë vit vërehen përmirësime të dukshme në MPMS, pra ka adresuar mbi 95% të rekomandimeve.

Abdyl Ymeri diskutoi sa i përket implementimit të rekomandimeve për KGJK dhe Policinë e Kosovës edhe atë: KGJK ishte një numër prej 7 rekomandimeve, mirëpo rekomandimi 3 dhe 4 janë diskutuar më së tepërmi. Pra, rekomandimi 3, ky rekomandim ka të bëjë me urdhër- blerjet, në disa fusha kemi bërë përmirësime, por në disa e kemi disi të pamundur me krye këtë, sidomos për karburante, sepse nuk dihet sa kanë me u harxhuar gjatë muajit dhe të mirëmbajtja e automjeteve nuk dihet cilat pjesë kanë me u ndërruar. Po ashtu teknikisht ka qenë e pamundur të kryhen me kohë, sepse sistemi i pagesave të Ministrisë së Financave, një periudhë të gjatë nuk ka funksionuar fare. Një çështje tjetër është se vitin e kaluar kemi filluar me e bartë te Gjykatat, pra ka filluar procesi i decentralizimit, dhe besoj që këtë telashe nuk do ta kemi gjatë vitit 2017. Arsyetimi i KGJK-së, i kemi ende të mblledhura rreth 2 mijë deri në 3 mijë pagesa. Mirëpo kjo ka ndodhur për shkak të ndërrimit të softuerit të sistemit të pagesave, për këtë është krijuar zinxhiri për të cilin nuk mundemi me zhbllokuar menjëherë, por që presim shumë shpejt ta rregullojmë këtë çështje. Në bazë të diskutimeve të përbashkëta edhe me Auditorët e jashtëm, mund të konkludojmë që KGJK, ka adresuar 75%, të rekomandimeve.

Hajdar Beqa theksoi se është mirë që Institucionet t'i mbajmë përgjegjës në kontest të implementimit të rekomandimeve. Qeveria duhet të ketë mekanizma për implementim të rekomandimeve dhe të jetë më përgjegjëse për shpenzim më racional të buxhetit.

Kryetari theksoi se kemi dy propozime, që KMFP të adresojë këtë çështje në seancë plenare për diskutim dhe që KMFP të përgatitë një informatë vetëm për Kryesi. Pastaj Kryesia të vendos se a do të duhet të shkojë për seancë plenare raporti për implementim të rekomandimeve.

Përfundim

KMFP vendosi t'i paraqesë Kryesisë së Kuvendit një informatë lidhur me angazhimet e KMFP në kontest të adresimit të rekomandimeve të KMFP, si dhe të Seancës Plenare.

4. Të ndryshme

Faton Topalli, kryetar, tha se kemi dy çështje për t'i diskutuar në Komision; e para ka të bëjë me një ftesë nga KFOS- i lidhur me një punëtori që do të mbahet nga data 23 deri më 26 qershor 2016, lidhur me Industrinë nxjerrëse dhe të ardhurat nga kjo, e që kërkohet caktimi i dy zyrtarëve të Komisionit në këtë punëtori. Çështja e dytë ka të bëjë me buxhetin e Komisionit në shumën prej 5.000 euro ndarje vjetore dhe si mendoni ta shpenzojmë, përmes ndonjë punëtorie apo me angazhim të ekspertëve për të na ndihmuar në analizim të raporteve të auditimit? Me këtë e hapi diskutimin.

Naim Fetahu tha se sa i përket stafit mendoj se të dytë, stafi i KMFP mund të marrin pjesë në punëtori, se edhe ashtu vetëm dy stafe kemi në Komision. Ndërsa sa i përket buxhetit mendoj se më mirë kishte me qenë që ne t'i mbajmë disa punëtori dhe të shqyrtojmë raportet se sa të angazhojmë ekspertë në këtë drejtim.

Faton Topalli, kryetar, pasi nuk pati të interesuar për të diskutuar, hodhi në votim propozimin për pjesëmarrje në punëtori të stafit. Ndërsa buxheti i Komisionit do të diskutohet në takimin e radhës së KMFP- së.

Përfundim

KMFP vendosi që në punëtorin për industrinë nxjerrëse dhe ndikimi në të ardhurat e organizuar nga KFOS, nga data 23-26 qershor 2016, do të marrin pjesë Antigona Ibraj, koordinatorë e Komisionit dhe zyrtari i fushës për ekonomi, Mehmet Simnica.

Takimi përfundoi në orën 12:00.

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Faton Topalli